Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0567

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.N.SH. "Vizion Project" Lot 4 , kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Kompani konsulentë për hartimin e raporteve të hollësishme të auditimit energjetik, dizajnëve të hollësishme dhe specifikimeve teknike, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen ne adresimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për implementimin e masave te EE në ndërtesat shumë-banesore (sociale) komunale" Lot 4, me numër të prokurimit VET-FKEE2020-23-3696-2-1-1, me 15/12/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE N.N.SH. "Vizion Project" Lot 4, me nr. 2023/0567 , e datës 11/08/2023, kurse vendimi i AK "Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Kompani konsulentë për hartimin e raporteve të hollësishme të auditimit energjetik, dizajnëve të hollësishme dhe specifikimeve teknike, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen ne adresimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për implementimin e masave te EE në ndërtesat shumë-banesore (sociale) komunale" Lot 4, me numër të prokurimit VET-FKEE2020-23-3696-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.N.SH. "Vizion Project",

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.04.2023, "Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Kompani konsulentë për hartimin e raporteve të hollësishme të auditimit energjetik, dizajnëve të hollësishme dhe specifikimeve teknike, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen ne adresimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për implementimin e masave te EE në ndërtesat shumë-banesore (sociale) komunale" Lot 4 Ndërsa me datën 27.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Ndërtimi AK SHPK"- Kamenicë

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 112,500 €.

Me 01.08.2023, OE N.N.SH. "Vizion Project", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.SH. "Vizion Project", me nr. 567/23 për lidhur me aktivitetin "Kompani konsulentë për hartimin e raporteve të hollësishme të auditimit energjetik, dizajnëve të hollësishme dhe specifikimeve teknike, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen ne adresimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve, për implementimin e masave te EE në ndërtesat shumë-banesore (sociale) komunale" Lot 4 me numër të prokurimit VET-FKEE2020-23-3696-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesN.N.SH. "Vizion Project", janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi *: "Njoftimi i parë mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt.19.05.2023, ku është rekomanduar për kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik Ndërtimi Ak Sh.P.K.; Saeptum D.O.O, Koretin, 62000, Kamenicë, Kosovë me çmim prej 107,200 Euro ndërsa neve ishim eliminuar me arsyetimin se: "Kompania nuk ka dërguar referenca të mjaftueshme për përvojën në auditime të energjisë të projekteve në fushën e Efiçiencës së Energjisë së paku tri vitet e shkuara.Pas këtij njoftimi, ne kemi iniciuar procedurën ligjore të ankimimit, ku kemi parashtruar kërkesë për*

rishqyrtim dt.24.05.2023, ndërsa refuzimi i kërkesës për rishqyrtim ishte bërë me dt.30.05.2023.Pas këtij refuzimi kishim parashtruar ankesë në OSHP dt.08.06.2023, ndërsa ekspertiza ishte lëshuar me (It. 14.06.2023 me Nr.2023/0365 ku ishte aprovuar ankesa dhe lënda ishte rekomanduar që të kthehet në rivlerësim. Pasi që ishte lëshuar ekspertiza ne ishim pajtuar me ekspertizë por ishte pajtuar edhe autoriteti kontraktues me shkeljet që i kishte konstatuar eksperti shqyrtues. Mbi këtë bazë ishte lëshuar vendimi i panelit shqyrtues Nr. 2023/0365 dt.05.07.2023 për pajtim të palëve dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim.

Pas kthimit të lëndës në rivlerësim është nxjerr Njoftimi mbi vendimin e AK-së me dt.27.07.2023 ku është vendosur sikurse në vlerësimin e parë. Pra është rekomanduar për kontratë "NDËRTIMI AK SH.P.K.; SAEPTUM D.O.O, Koretin, 62000, Kamenicë, Kosovë dhe ne jemi eliminuar përsëri me të njëjtat arsye.Nga ky veprim i AK-së kuptohet se është vepruar kundërligjshëm dhe nuk është respektuar ekspertiza e ekspertit shqyrtues dhe vendimi i panelit shqyrtues Nr. 2023/0365 dt.05.07.2023 dhe tashmë kjo lëndë është Res Judicata sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së.Ne përsëri kemi kërkuar qasje në dokumentacion të këtij tenderi dhe kemi vërejt se AK-ja ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë.Me sqarime, i njëjti operator ekonomik është munduar ti mbulojë mangësitë e dëshmive të dorëzuara me rastin e ofertimit.I njëjti OE ka ofruar dëshmitë e përkthyera për inxhinierin e arkitekturës Toni Borkovic në gjuhen shqipe, mirëpo që këto përkthime nuk mbajnë datë se kur janë përkthyer, prandaj këto dëshmi nuk duhet të merren parasysh sepse neni 72.3 i LPP-së e parasheh qartë që:Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Në këtë rast ekzistenca e këtyre përkthimeve nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar para hapjes së ofertave, prandaj nuk mund të merren parasysh këto dëshmi. PO ashtu janë kërkuar sqarime edhe për inxhinierin e makinerisë Ismar Jamakovic i cili e kishte ofruar diplomën në gjuhën boshnjake të Fakultetit të Sarajevës.Edhe për këtë inxhinier, me sqarime janë ofruar dokumentet e përkthyera në gjuhen shqipe, mirëpo përkthimet që janë bërë në gjuhen shqipe janë bërë nga një përkthyese serbisht shqip dhe anasjelltas e jo përkthime nga gjuha kroate apo boshnjake në gjuhen shqipe, prandaj edhe ky është një argument shtesë dhe krucial se këto përkthime janë bërë tani gjatë kërkesës për sqarime. Pra kjo është dëshmi se nuk kanë ekzistuar këto dëshmi të përkthyera në gjuhën shqipe para datës së hapjes së ofertave, prandaj duhet të mos merren parasysh këto dëshmi dhe duhet të eliminohet OE i rekomanduar për kontratë.Gjithashtu edhe sa i përket kontratave OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dokumentet e përkthyera në gjuhen shqipe, mirëpo përkthimet që janë bërë në giuhen shqipe janë bërë nga një përkthyese serbisht shqip dhe anasjelltas e jo përkthime nga gjuha kroate apo boshnjake në gjuhën shqipe. Andaj edhe në këtë rast kuptohet qartë se përkthimet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, janë bërë gjatë fazës së kërkesës për sqarime, pasi që dokumentet e prezantuara nuk përmbajnë datë se kur janë të përkthyera.OE i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar dokumente të përkthyera në gjuhen shqipe edhe për qarkullimin bankar, mirëpo që edhe në këtë rast përkthimet që janë bërë në gjuhën shqipe janë bërë nga një përkthyese serbisht shqip dhe anasjelltas e jo përkthime nga gjuha kroate apo boshnjake në gjuhën shqipe.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertë pas sqarimeve shtesë edhe një referencë për inxhinierin e arkitekturës Toni Borkovic, e të cilit dokument i figuron data 21.072023, pra datë kjo e Cila është pas hapjes së ofertave. Dokumenti i tillë nuk mund dhe nuk është dashur të merret parasysh nga ana e AK-së pasi që është dokument i cili është prezantuar me datë pas hapjes së ofertave. Në lidhje me arsyen e eliminimit tonë, ashtu siç e kemi cekur edhe në kërkesën e kaluar për rishqyrtim, ju sqarojmë se AK-ja na ka diskriminuar neve duke na eliminuar pa asnjë argument konkrete dhe pa bazë ligjore duke mos i marr parasysh dëshmitë tona që i kemi bashkangjitur me dosje të tenderit. Ju sqarojmë se ne kemi bashkangjitur listën e projekteve të përfunduara ku janë të llastuara 17 kontrata, ku prej tyre numri më i madh i kontratave janë të natyrës siç është kërkuar në dosje të tenderit, prandaj për neve është e habitshme arsyeja e eliminimit kur kemi parasysh dëshmitë që i kemi bashkangjitur me dosje të tenderit e ku dëshmohet përvoja adekuate siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar si në vijim: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës së ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare. Kurse dëshmia e kërkuar dokumentare ka qenë si në vijim: Listën e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë, duhet të dorëzohet ne origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe te bashkëngjiten si dëshmi edhe referenca Ose pranimi përfundimtar, Kompania të ketë përvojë në auditime, dizajnë dhe mbikëqyrje, referencat duhet te jene ne Auditime te energjisë, dizajnë dhe mbikëqyrje të projekteve në Efiçiencë së Energjisë se paku 3 vitet e shkuara (dëshmi se paku 3 projekte — me referenca nga përfituesit).Pra kërkesë ka qenë që të ofrohen dëshmi për kontrata të ngjashme, e po ashtu është edhe tek dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar decidivisht lista e kontratave të ngjashme, ndërsa ne kemi ofruar shumë kontrata të natyrës së ngjashme. Më pastaj është cekur që kompania të ketë përvojë në auditime, dizajn dhe mbikëqyrje, kurse ne kemi ofruar dëshmi kontrata dhe referenca për përvojë në auditime, dizajn dhe mbikëqyrje.Duke pasur parasysh dëshmitë që i kemi ofruar kërkojmë nga ju që të detyroni AK ti analizoj edhe njëherë dëshmitë dhe dokumentet tona dhe më pastaj të nxjerrët një vendim meritor dhe i mbështetur në fakte dhe dëshmi konkrete, sepse ne e plotësojmë kërkesën e nenit 9.1&9.2 të FDT-së në lidhje me kontratat dhe referencat e natyrës së kontratës.Nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me këto dëshmi atëherë është dashur ta shfrytëzoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së. Faktin se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e paqëndrueshme e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e dl. 14.06.2023 me nr.2023/0365, ku i njëjti kishte konstatuar si në vijim "Nga provat prezantuara vërtetohet se OE ka ofruar dëshmi për 14 projekte te realizuara ne kuadër te kontratës me FKEE si dhe projekte tjera te realizuara. Ankesa e OE për mendimin e ekspertit shqyrtues është e bazuar, ne këtë rast AK nuk e ka marre parasysh nenin 59 te LPP, përkatësisht paragrafi 2 citim: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Dhe nenin 72 te LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtese Me

këtë konstatim të ekspertit shqyrtues është pajtuar edhe autoriteti kontraktues, mirëpo që çuditërisht tani me rastin e publikimit të njoftimit mbi vendimin AK-ja përveç se nuk ka vepruar konform konstatimit të ekspertit shqyrtues, i cili e ka aprovuar pretendimin tonë ankimor, e njëjta nuk ka vepruar edhe sipas vendimit të lartcekur të OSHP-së.Me këtë veprim të AK-së, edhe një herë po shfaqet haptas diskriminimi që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit. Nga ky veprim i AK-së kuptohet se edhe në këtë rast është vepruar kundërligjshëm dhe nuk është respektuar ekspertiza e ekspertit shqyrtues dhe vendimi i panelit shqyrtues Nr. 2023/0365 &.05.07.2023 dhe tashmë kjo lëndë është Res Judicata sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së.Ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë sqarimet e OE nuk duhet të merren parasysh, pasi që edhe eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së e kanë aprovuar si të bazuar ankesën tonë, andaj edhe një herë ne po i parashtrojmë pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë e i cili siç e cekëm edhe më lartë është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim: Ne, pas qasjes që kemi pasur në dokumentacion të grupit të OE të rekomanduar për kontratë Ndërtimi AK Sh.P.K.; Saeptum D.O.O, Koretin, 62000, Kamenicë, Kosovë kemi vërejtur se oferta e këtij grupi ka shumë mangësi dhe dokumente të parregullta, e të cilat e bëjnë të papërgjegjshëm plotësisht.Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse anëtari i konsorciumit SAEPTUM D.O.O ka ofruar dëshmi dhe dokumente në Gjuhën kroate, e cila nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë dhe ky akt bie në kundërshtim me nenin 13.4 të LPP-së ku ceket qartë që "Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe Ose në gjuhën Angleze". Anëtari i konsorciumit "Saeptum D.O.O" ka ofruar diplomën e inxhinierit të arkitekturës Toni Borkovic në gjuhen kroate. Po ashtu ka ofruar edhe referenca në gjuhën kroate dhe një dokument me titullin uvjerenje.Për inxhinierin e makinerisë Ismar Jamakovic e ka ofruar diplomën në gjuhën boshnjake të Fakultetit të Sarajevës, të pa përkthyer në ndonjërën gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.Për këtë inxhinier janë ofruar dy dokumente me titull Uvjerenje dhe siç duket të përkthyer në gjuhë angleze, mirëpo nuk janë te përkthyera nga përkthyes zyrtar gjyqësor por me sa kuptohet kanë një përkthim jozyrtar, e ku këto dokumente edhe nëse do të ishin të përkthyera nuk duhet të merren parasysh sepse nuk janë të përkthyera zyrtarisht. Anëtari i grupit të OE të rekomanduar për kontratë SAEPTUM D.O.O ka bashkangjitur edhe disa dokumente me te dhëna për qarkullimin financiar nga institucione të Kroacisë në gjuhën Kroate, që nuk duhet të merren parasysh, e gjithashtu në dosje të tenderit është kërkuar si dëshmi të ofrohen Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. Pra nuk është parashikuar një mundësi e ofrimit të deklaratave tatimore nga ndonjë shtet tjetër, prandaj ky konsorcium është i papërgjegjshëm. I njëjti OE i ka ofruar edhe referencat në gjuhën kroate dhe nuk ka ofruar përkthim zyrtar.Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar edhe kërkesën e nenit 9.1&9.2 të FDT-së ku është kërkuar: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës së ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare. Kurse dëshmia e kërkuar dokumentare ka qenë si në vijim: dëshmia- Listën e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë, duhet të dorëzohet ne origjinal e nënshkruar dhe e

vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe te bashkëngjiten si dëshmi edhe referenca Ose pranimi përfundimtar, Kompania të ketë përvojë në auditime, dizajnë dhe mbikëqyrje, referencat duhet te jene ne Auditime te energjisë, dizajnë dhe mbikëqyrje të projekteve në Efiçiencë së Energjisë se paku 3 vitet e shkuara (dëshmi se paku 3 projekte — me referenca nga përfituesit). Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur këtë kërkesë sepse nuk ka ofruar dëshmi për kontrata të natyrës së ngjashme dhe që ka përvojë në auditime, dizajn dhe mbikëqyrje, referencat duhet të jenë ne Auditime të energjisë, dizajnë dhe mbikëqyrje të projekteve në Efiçiencë së Energjisë se paku 3 vitet e shkuara.Gjithashtu i njëjti ka prezantuar edhe disa kontrata të cilat janë jashtë trevjeçarit të fundit, e që nuk duhet të merren parasysh.Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, ndërsa këtë fakt siç edhe e cekëm e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues dhe vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së dhe vendimi i panelit shqyrtues Nr2023/0365 dt.05.07.2023 dhe tashme kjo lëndë është Res Judicata sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së.Ne këtë tender, por veç që jemi ofertues i përgjegjshëm, ne kemi ofertuar dhe me çmim me të lire se sa grupi i OE të rekomanduar për kontratë, pra ne kemi ofertuar me vlerë prej 104,800.00 EUR, kurse grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 107,200 euro.Ne me dt.03.08.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar mirëpo që AK-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret dhe të mbështetur në dispozita ligjore konkrete, për një refuzim te tillë ne lidhje me pretendimin tone te parë AK-ja e ka cekur si në vijim:Përgjigje rreth pretendimit 1: Pretendimi i OE nuk është i vlefshëm sepse dokumentacioni i dërguar është ne gjuhen kroate, por AK ka bërë kërkesë tek OE për përkthenin e këtij dokumentacioni gjë e cila është bere nga ana e OE respektiv dhe i tere dokumentacioni është përkthyer ne gjuhen shqipe, gjë e cila ka plotësuar kushtin gjuhësor, por edhe atë kuptimor për AK dihet vlerësimin e ofertave ne mënyre objektive dhe jo diskriminuese. Arsyetimi i lartcekur i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ashtu siç edhe e kemi cekur ne kërkesën për rishqyrtim, sqarimet e kërkuara nuk është dashur dhe nuk mund të merren parasysh për faktin se të njëjtat përkthime nuk mbajnë datë se kur janë përkthyer, prandaj këto dëshmi nuk duhet të merren parasysh sepse neni 72.3 i LPP-së e parasheh qartë që: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm por dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Në këtë rast ekzistenca e këtyre përkthimeve nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar para hapjes së ofertave, prandaj nuk mund të merren parasysh.Për me tepër përkthimet që janë bërë ne gjuhen shqipe janë bërë nga një përkthyes serbisht shqip dhe anasjelltas e jo përkthime nga gjuha kroate apo boshnjake ne gjuhen shqipe, prandaj siç edhe e kemi cekur më lartë ky është një argument shtesë dhe krucial se përkthimet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë bëre tani gjatë kërkesës për sqarime. Pra kjo është dëshmi se nuk kanë ekzistuar këto dëshmi të përkthyera ne gjuhen shqipe para datës se hapjes së ofertave, prandaj duhet të mos merren parasysh këto dëshmi dhe duhet të eliminohet OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo AK-ja nuk ka vepruar në këtë mënyrë por e ka rekomanduar për kontratë të njëjtin OE, duke mos e respektuar vendimin e panelit shqyrtues. Ne lidhje me pretendimin tonë ankimor, sa i përket arsyes së eliminimit të kompanisë tonë, AK-ja ka dhënë arsyetimin si ne vijim: "Edhe pas kriterit qe kompania duhet te ketë përvojë ne auditm,

dizajn dhe nibikëqyrje, ju si OE nuk keni arritur te dëshmoni me referenca ne atë qe pretendoni si edhe e keni cekur dhe tek ju figuron vetëm një reference për Auditm, dhe si rezultat ne kemi vlerësuar sipas dokumenteve qe ju keni ofruar dhe bazuar në neni 10.1 Udhezues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik - nëse lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar me dosjen e tenderit: Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm bazuar neni 69 LPP. Kompania juaj lidhur me këtë pike ka dorëzuar ne AK disa kontrata ne te cilat ka kryer projekte dhe kontrata te cilat janë implementuar masat e EE-se, por kontrata e vetme e paraqitur nga ana e juaj si OE dhe ku keni kryer auditim, dizajn dhe mbikëqyrje është kontrata me FKEE dhe si e tillë dhe e vetme nuk e ka përmbushur kushtin prej 3 referencash. Kontrata e vetme qe i përmbush kërkesat dhe kriteret e vendosura ne DT, duke përfshirë Auditimin ana e kompanisë tuaj është:I. Hartimi i Projekteve te Detajuara, Specifikimet Teknike duke përfshire Dizajnin, Mbikëqyrjen, Komision imin dhe Mbikëqyrjen e Menaxhimit gjate Periudhës se Përgjegjësisë se Defekteve, për Rinovimin e Ndërtesave për te siguruar shfrytëzim Eficient te Energjisë- Lot 3 (Një kontrate me 14 nen-projekte) ". Ndërsa sa i përket kërkesës së ekspertit shqyrtues, AK e ka respektuar mendimin e ekspertit dhe e kemi kthyer lëndën në rishqyrtimAK-ja përsëri me arsyetime të paqëndrueshme na ka diskriminuar neve si kompani e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit dhe e njëjta është munduar të devijoj nga faktet të cilat i kemi prezantuar ne dhe gjithashtu ka devijuar edhe nga ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ku e ka cekur se kinse ka vepruar konform ekspertizës së ekspertit pasi që lënda është kthyer në rivlerësim.Arsyetimi i AK-së nuk qëndron pasi që edhe kontratat tjera të prezantuara nga ne përveç kontratës që e ka cekur AK-ja, kanë të bëjnë me natyrën e kërkuar siç është auditim, dizajn dhe mbikëqyrje. Vlen të ceket fakti se e njëjta ka bërë përsëritjen e arsyetimin sikurse në vendimin për refuzim në herën e parë kur kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim, andaj ky fakt tregon qartë se AK-ja pa ndonjë argument që e dëshmon të kundërtën e pretendimeve tona ankimore ka bërë refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.Po ashtu po e sqarojmë edhe një herë se eksperti shqyrtues në ekspertizën e cit. 14.06.2023 me nr.2023/0365, kishte konstatuar si në vijim "Nga provat e prezantuara vërtetohet së OE ka ofruar dëshmi për 14 projekte te realizuara ne kuadër te kontratës me FKEE si dhe projekte tjera te realizuara. Ankesa e OE për mendimin e ekspertit shqyrtues është e bazuar, ne këtë rast AK nuk e ka marre parasysh nenin 59 te LPP, përkatësisht paragrafi 2 citim: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve, Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Dhe nenin 72 te LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtese".Me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues jeni pajtuar është pajtuar edhe autoriteti kontraktues, mirëpo që tani po vepron në kundërshtim me raportin e ekspertit me të cilin vet AK-ja është pajtuar dhe njëkohësisht nuk po e respekton vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së, mirëpo me arsyetime të pa bazuara, po mundohet të devijoj nga pretendimi ynë. Andaj ashtu siç është shpjeguar më lartë kuptohet qartë se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.Sa i përket pretendimit tonë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me kërkesën sa i përket kontratave AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim "Kriteri i dhënies se kontratës ka qene Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm, e Cila fillimisht trajton

çështjen e te qenit i përgjegjshëm, e pastaj ekonomikisht me i favorshëm. Ju nuk keni plotësuar kriteret minimale te përcaktuara ne FDT siç e keni pohuar edhe ju vet, nuk keni ofruar referenca për auditime te energjisë kriter ky decitivisht dhe përmes funksionit "dhe e jo "ose" qe referencat duhet te jene ne Auditime te energjisë, dizajnë dhe mbikëqyrje te projekteve në Efiçiencë së Energjisë se paku 3 vitet e shkuara (dëshmi se paku 3 projekte — me referenca nga përfituesit) Bazuar në neni 10.1 Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik — nëse Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar me dosjen e tenderit: Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm bazuar neni 69 LPP.AK ka bërë kërkesë tek OE për përkthimin e këtij dokumentacioni gjë e cila është bërë nga ana e OE respektiv dhe i tere dokumentacioni është përkthyer ne gjuhen shqipe, gjë e cila ka plotësuar kushtin gjuhësor, por edhe atë kuptimor për AK dhe vlerësimin e ofertave ne mënyrë objektive dhe jo diskriminuese Ashtu siç e cekëm edhe më lartë edhe ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar për faktin seOE i rekomanduar për kontratë nuk e ka "përmbushur këtë kërkesë s se nuk ka ofruar dëshmi për kontrata të natyrës se ngjashme dhe që ka provojë ne auditime, dizajn dhe mbikëqyrje, referencat duhet të jene ne Auditime të energjisë, dizajnë dhe mbikëqyrej të projekteve ne Efiçiencö së Energjisë se paku 3 vitet e shkuara. Gjithashtu i njëjti ka prezantuar edhe disa kontrata të cilat janë jashtë trevjeçarit të fundit, e që nuk duhet të merren parasysh, mirëpo që AK-ja edhe përkundër këtij fakti i ka marr parasysh të njëjtat kontrata.Duhet cekur fakti se OE i rekomanduar për kontratë sa i përket kontratave ka prezantuar dokumentet e përkthyera në gjuhen shqipe, mirëpo përkthimet qe janë bere në gjuhën shqipe janë bërë nga një përkthyese serbisht shqip dhe anasjelltas e jo përkthime nga gjuha kroate apo boshnjake ne gjuhen shqipe. Andaj edhe në këtë rast kuptohet qartë se përkthimet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, janë bëre gjatë fazës së kërkesës për sqarime, pasi që dokumentet e prezantuara nuk përmbajnë datë se kur janë të përkthyera, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh këtë fakt.Po ashtu e njëjta në arsyetimin e lartcekur e theksuar se kinse ne e kemi pohuar se nuk kemi ofruar referenca për auditime te energjisë, mirëpo ky arsyetim i AK-së nuk qëndron pasi që ne pretendimin tonë e kemi cekur shumë qartë se e plotësojmë kërkesën e dosjes së tenderit, por me tepër një fakt te tillë e ka vërtetuar edhe eksperti shqyrtues i OSHP-se. AK-ja është munduar me arsyetime te paqëndrueshëm të ve në lajthitje edhe OSHP-në, pasi që asnjëherë nuk e kemi pohuar se kinse ne nuk kemi referenca për auditim të energjisë.Më tutje në vendimin për refuzim AK-ja ka bërë përshkrim të dispozitave për të cilat ne e kemi cekur se nuk janë respektuar, mirëpo që e njëjta nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret qe tregon se pretendimet tona janë të paqëndrueshme, mirëpo vetëm e ka cekur se janë respektuar dispozitat ligjore.Duke u bazuar ne faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se nga argumentet e lartcekura kuptohet qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht jemi eliminuar në kundërshtim me ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues te OSHP-së.Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-se, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulet.Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulet, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të

LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe te njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, kurse paragrafi I i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik ne mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.Po ashtu është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë duke u shpall fitues edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm, ndërsa me këtë rast veprimet e AK-së kane rënë ndesh edhe me paragrafin 6 të nenit 7 pika (vi) ku shkruan që "Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëseGjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin I dhe nenin 6 tëLPP-së, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa ju në këtë rast keni vepruar në kundërshtim me këto dispozita dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.Ju njoftojmë se kjo lëndë është dhe duhet të trajtohet si çështje e gjykuar (Res Judicata) sipas vendimit të panelit shqyrtues Nr. 2023/0365 dt.05.07.2023 dhe sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE N.N.SH. " Vizion Project"- Prishtinë, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 13, 56, 59, 60, 69, të si dhe vendimin e OSHP-së nr.2023/0365 dt.05.07.2023 duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që te aprovohet ankesa jon si e bazuar te anulohet njoftimi mbi vendimin B58 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim, dhe te detyrohet AK qe gjatë rivlerësimit , ekzaminimit , vlerësimit dhe krahasimit te ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit , njoftimit për kontratë dhe komform dispozitave te LPP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 15/08/2023 ka autorizuar eksperten për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 567/23, ndërsa me datë 28/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0567 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. *Autoriteti Kontraktues ne përgjigjen e tij lidhur me rekomandimin e ekspertit deklaron se Nuk Pajtohet. Ndërsa se pajtohem me rekomandimin e ekspertes që lënda të kthehet në rivlerësim, mirëpo nuk pajtohem me eksperten shqyrtuese që ankesa të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Ankesa është dashur të konsiderohet plotësisht si e bazuar....*

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe

dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.N.SH. "Vizion Project"- Prishtinë eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0567 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor ekspertja sqaron se *"Me datën: 11.08.2023, OE "N.N.SH. " Vizion Project "'"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0567, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Ndërtimi AK SHPK"- Kamenicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Kompani konsulentë për hartimin e raporteve te hollësishme te auditimit energjetik, dizajnëve të hollësishme dhe specifikimeve teknike, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen ne adresimin e defektve gjate periudhës se garancisë se punimeve, për implementimin e masave te EE ne ndërtesat shume-banesore (sociale) komunale" me nr. të prokurimit: "VET-FKEE2020-23-3696-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Fondi 1 Kosovës Për Efiçiencë Të Energjisë. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në pretendimet e ngritura ka shprehur mendimin e tij. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në pretendimin e ngritur nga OE ankues- Vizioni Project, përmes kërkesës për sqarime shtesë ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues- Fondi I Kosovës Për Efiçiencë Të Energjisë që të dërgoj të gjitha dokumentet e përkthyera të cilat janë dorëzuar nga OE i rekomanduar pas kërkesës për sqarim të bërë nga AK, pasi që lënda është kthyer në rivlerësim.Pasi janë analizuar dokumentet e dërguara nga OE i rekomanduar pas kërkesës për sqarim, eksperti shqyrtues sqaron se këto materiale të dorëzuara, janë dokumente të cilat edhe më herët kanë qenë pjesë e ofertës të OE i rekomanduar në gjuhën origjinale. Materialet e përkthyera, secila prej tyre ka një vulë të përkthyesit i cili tregon se i njëjti dokument ekzistues është përkthyer nga një gjuhë tjetër (kroate, boshnjake) në gjuhën shqipe, andaj të njëjtat nuk kanë asnjë ndryshim material nga dokumentet e dorëzuara me ofertë. Mendimi i ekspertit shqyrtues është se përderisa diploma, referencat dhe dokumentet e tjera relevante të cilat janë kërkuar të përkthehen, kanë një vulë të përkthyesit dhe gjithashtu secila prej tyre në origjinal ka ekzistuar edhe në ofertë të OE i rekomanduar, dhe gjithashtu secila prej tyre ka edhe datën se kur është lëshuar në origjinal, konsiderojmë se këto materiale të dorëzuara janë në rregull. Sa i përket pretendimit se me informatat e kërkuara është dërguar edhe një referencë e inxhinierit të arkitekturës Toni Borkovic, të cilës i figuron data 21.07.2023, eksperti sqaron se me dokumentet e pranuara nga AK përmes e-mailit pas kërkesës së ekspertit, në dosjen e z. Borkovic nuk figuron asnjë referencë e cila ka datën pas hapjes së ofertave ashtu siç është pretenduar. Duke marr parasysh se ekzistenca e secilit dokument të kërkuar që të përkthehet është e fiksuar në origjinal dhe është para datës së skadimit për dërgimin e tenderëve të cilat janë dorëzuar nga OE i rekomanduar dhe të njëjtat gjenden edhe në ofertë, me këtë çfarë u tha më lartë, vlerësojmë se ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i pabazuar. Kurse sa i përket pjesës tjetër të pretendimeve të ngritura, eksperti shqyrtues sqaron se për të njëjtat pretendime është lëshuar një raport i ekspertizës nga eksperti paraprak, me të cilën janë pajtuar të dy palët, AK- FKEE dhe OE ankues- Vizioni Project dhe lënda është kthyer në rivlerësim dhe si rezultat i këtij pajtimi është lëshuar edhe vendimi nga paneli shqyrtues. Duke u bazuar nga ajo çfarë u tha më lartë, sipas LPP-së, tashmë ky rast është i gjykuar edhe më herët dhe për të njëjtin ka një vendim të nxjerrë*

*nga Paneli Shqyrtues- OSHP, Vendim me numër **2023/0365** i datës 05/07/2023."*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankuesN.N.SH. "Vizion Project"- Prishtinë,. Argumentimi në raportin e ekspertes është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "N.N.SH. "Vizion Project"- Prishtinë, janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Kompani konsulentë për hartimin e raporteve te hollësishme te auditimit energjetik, dizajnëve të hollësishme dhe specifikimeve teknike, mbikëqyrjen e punëve ndërtimore, komisionimin duke përfshirë mbikëqyrjen ne adresimin e defekteve gjate periudhës se garancisë se punimeve, për implementimin e masave te EE ne ndërtesat shume-banesore (sociale) komunale" Lot 4 me nr. të prokurimit: "VET-FKEE2020-23-3696-2-1-1".

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësimit dhe AK të veproj konform kërkesave ligjore dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit.Në procedurën e rivlerësimit po ashtu obligohet ti marr parasysh gjetjet e ekspertit shqyrtues të dhëna edhe në vendimin paraprak të OSHP nr. 365/23, për të cilin është raport të ekspertizës AK është pajtuar, andaj, të veproj në harmoni me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 115 të LPP.Paneli sqaron per AK që të gjitha vendimet e OSHP kanë karater urdhërues dhe zbatues per palët në procedurë dhe si të tilla duhet të zbatohet në përpikëri, ku sipas të lartëcekurave vërehet se AK nuk ka vepruar në harmoni të plotë me

udhëzihet/rekomandimet e panelit, andaj nëse paneli vëren se AK sërish nuk zbaton një vendim të till ka të drejtë të kërkoj marrjen e masave nga KRPP për revokim të çertifikatës konform paragrafit 8 dhe 9 të nenit 25 të LPP.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**
- OE - **N.N.SH. " Vizion Project "**
- Arkivës së OSHP-së: